



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT
të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të
Komunës së Prishtinës, mbajtur më 23.3.2012, e cila filloi në orën 12:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sami Hamiti, Mustafë Krasniqi, Tefik Mehmeti, Hazir Borovci, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.

Mungoi Engin Beyoglu (me leje).

Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesit e OSBE - së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Sami Hamiti, kryesues.

Njëzëri u miratua ky

REND DITE :

- 1. Informata e Policisë së Kosovës lidhur me gjendjen e sigurisë në komunën e Prishtinës;**
- 2. Propozimvendimi për llogaritjen dhe kompensimin për vlerësimin, mbikëqyrjen, pranimin teknik dhe kolodimin e investimeve komunale dhe investimeve të tjera në Komunën e Prishtinës;**
- 3. Propozimvendimi për caktimin e kriterëve bazë për ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirave banesore - afariste;**
- 4. Propozimvendimi për inkorporimin e projekteve të infrastrukturës rrugore në planet rregulluese;**
- 5. Propozimvendimi për shfuqizimin e Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës komunale për vendosjen e objekteve të përkohshme;**
- 6. Raporti vjetor i Komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike komunale “Sport – Marketing”;**
- 7. Të ndryshme.**

Pika e parë

U konstatua njëzëri se u përkrah Informata e Policisë së Kosovës lidhur me gjendjen e sigurisë në komunën e Prishtinës që të shqyrtohet në mbledhjen e Kuvendit.

Pika e dytë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës të pranishmit i informoi **Behxhet Musliu**.

Avdullah Hoti tha se në nenin dhjetë të këtij propozimvendimi duhet të shtohet "... dhe Vendimi për mënyrën e llogaritjes dhe lartësinë e kompensimit për pranimin teknik të objekteve, 01. nr. 400-1599, të dt. 29.10.2010".

Kryesuesi tha se ka pas komente rreth këtij vendimi, por është marrë pëlqimi nga Ministria përkatëse, andaj konsiderojmë se çdo gjë lidhur me këtë propozim është në rregull.

Aziz Pacolli theksoi se edhe më parë ka pasur disa komente rreth asaj se kanë, apo nuk kanë të drejtë të jenë pjesëmarrës të këtij komisioni punonjësit e Komunës.

Tefik Mehmeti tha se do të ishte më mirë që punonjësit e Komunës të marrin pjesë në Komisionin për pranimin teknik, dhe me ligj lejohet puna jashtë orarit deri në 40 orë në muaj, andaj në këtë rast nuk kemi të bëjmë me konflikt interesi. Në nenin 3, pika 5, të hiqet pjesa e fjalisë "komisioni do të vlerësojë pjesërisht ...". Në nenin 4, pika 2, të mbetet vetëm zyrtari kryesor administrativ, ndërsa pjesa tjetër të hiqet.

Behxhet Musliu paraqiti sqarime shtesë.

Shemsi Veseli shprehu mendimin se dështimet që po ndodhin te ne, janë rezultat i nxjerrjes së rregulloreve dhe vendimeve në të cilat nuk kyçen qytetarët gjatë diskutimeve publike. Askush nuk mund të nënshkruaj vendime me diplomë "Bachelor", gjë që në këtë rast janë dy zyrtarë me diploma të tilla, dhe ka raste që është bërë pranimi teknik pa leje ndërtimi. Ai propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të dërgohet në diskutim publik, ku qytetarët do të kenë mundësitë t'i shprehin qëndrimet e tyre.

Kryesuesi dhe **Behxhet Musliu** reagueshan ndaj akuzës së bërë nga Shemsi Veseli, se ka raste kur është bërë pranimi teknik pa leje të ndërtimit, duke thënë se nuk ka raste të tilla, njëherësh paraqitën edhe sqarime shtesë.

Aziz Pacolli kërkoi që në mbledhje të Kuvendit të sqarohet se ka apo nuk ka shkelje.

U konstatua se me shumicë votash, një votë kundër, u përkrah Propozimvendimi për llogaritjen dhe kompensimin për vlerësimin, mbikëqyrjen, pranimin teknik dhe kolodimin e investimeve komunale dhe investimeve tjera në Komunën e Prishtinës, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tretë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Behxhet Musliu**.

U konstatua njëzëri se u përkrah Propozimvendimi për caktimin e kriterëve bazë për ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirave banesore-afariste dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e katërt

Përkitazi me këtë pikë të rendit të ditës të pranishmit i informoi **Behxhet Musliu**, ndërsa arsyeshmërinë teknike e paraqiti **Ferid Fazliu**.

Ridvan Shahini paraqiti sqarime nga lëmi i infrastrukturës lokale.

Mustafë Krasniqi pyeti se a është bërë lëvizje e kyçjes së rrugës “Ekrem Rexha” në Unazën e brendshme të hekurudha.

Ferid Fazliu dhe **Ridvan Shahini** u përgjigjën në pyetjen e parashtruar.

Aziz Pacolli pyeti se kur do të fillohet me projekte të infrastrukturës nënrrugore.

Ai gjithashtu propozoi që me rastin e hartimit të një projekti të infrastrukturës rrugore, të parashihet edhe për atë nënrrugore, pasi që pas përfundimit të një projekti fillon projekti tjetër, i cili pason me dëmtime në infrastrukturë, siç është rasti me ndërtimin e sheshit “Ibrahim Rugova”, pas përfundimit të së cilit pritet fillimi i ndërtimit të ish-objektit Union etj.

Behxhet Musliu dhe **Ridvan Shahini** u përgjigjën në pyetjen e parashtruar dhe paraqitën sqarime shtesë.

Shemsi Veseli tha se me këtë po dëshmohet se ne kemi pasur të drejtë lidhur me Planin strategjik të Prishtinës, ku kemi probleme me plane të lagjeve si: “Tophane”, “Lakërishte”, “Mati I” etj. E metë e Komunës është se nuk ofron infrastrukturën rrugore, kanalizimin etj. Ku qëndron këtu llogaridhënia e drejtorisë që ka obligim t’i kryejë këto punë dhe atë nuk e bënë?!

Ai kërkoi që të jepen emrat e grupit të ekspertëve, të bëhet zgjidhje, por gjithnjë të jemi transparent.

U konstatua se u përkrah Propozimvendimi për inkorporimin e projekteve të infrastrukturës rrugore në planet rregulluese dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e pestë

Arsyeshmërinë për këtë pikë të rendit të ditës e paraqiti **Behxhet Musliu**.

Shemsi Veseli përkrahu arsyetimin e dhënë nga drejtorja dhe parimin që të mos ketë dualizmi, si dhe rishikimin e rregullores.

U konstatua se u përkrah njëzëri Propozimvendimi për shfuqizimin e Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës komunale për vendosjen e objekteve të përkohshme, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e gjashtë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, **Aziz Pacolli** tha se nuk është punuar asgjë dhe se ka pritur që të punohej më shumë.

U konstatua se u përkrah Raporti vjetor i Komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike komunale "Sport - Marketing" dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Ridvan Shahini informoi lidhur me shpalljen e tenderit për projekte nga lëmi i infrastrukturës lokale, ndërkaq **Behxhet Musliu** për punët e bëra nga lëmi i urbanizmit, me ç'rast kryesuesi shtoi se projektet e aprovuara duhet të inkuorohen në buxhet.

Tefik Mehmeti u shpreh se shpesh po i përziejme kompetencat, megjithatë ky raport është shumë i përgjithësuar dhe paraqet ngarkesë. Ne duhet të shikojmë se a janë të ruajtura asetet, interesi i komunës dhe çështjet e tjera elementare, e jo të merremi me detaje të panevojshme. Ndoshta do të ishte më mirë që kjo ndërmarrje të jetë në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

U konstatua se u përkrah Raporti vjetor i Komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike komunale "Sport - Marketing" dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e shtatë

Të ndryshme

Shemsi Veseli luti drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit që të ndërmarrë masat e nevojshme lidhur me mbindërtimet dhe ndërtimet e ballkoneve nëpër banesat e ndërtuara në lagjen "Arbëria" dhe në këtë mënyrë po devijohet projekti. Ai po ashtu kërkoi që të ndërmerren masa lidhur me uzurpimet e garazheve te kompleksi "Qafa".

Behxhet Musliu lidhur me këtë paraqiti sqarime, duke thënë se qytetarët do të duhej të informoheshin përkitazi me projektet përkatëse në lagjet e caktuara.

Mbledhja mbaroi në orën 13:30.

PROCESMBAJTËSJA

Alije Gusia

KRYESUESI I KOMITETIT

Sami Hamiti, ecc. i dipl.